

# SEKSIONI I ARESIMIT TE FILADELFIAS

No. 138

SEKSIONI: 100 programe

Titulli: Zhvillimi i Gjuhës Angleze / Programi  
i Edukimit Dygjuhësh

NDERTUAR: 18 janar 2018

RISHIKUAR:

## 138 ZHVILLIMI I GJUHES ANGLEZE / PROGRAMI I ARSIMIT DYGJUHËSH

### Qëllimi

Për të siguruar një program arsimor cilësor për të gjithë nxënësit, Seksioni i Arsimit të Filadelfias do të sigurojë një program mësimor të planifikuar të përshtatshëm kulturor dhe gjuhësor për nxënësit që mësojnë Gjuhën Angleze (EL), i cili bazohet në gjuhën dhe kulturën e familjeve të tyre. Qëllimi i programit do të jetë të sigurojë që EL-të në të gjitha nivelet e aftësisë gjuhësore të kenë të drejtën në standartet akademike të këtyre niveleve, dhe mbështet integrimin e nxënësve dhe pjesëmarrjen në komunitet. Nxënësit të cilët janë EL do të identifikohen, vlerësohen dhe do t'ju ofrohet një mundësi e barabartë për të marrë pjesë në programe mësimore me të drejta të barabarta në programe arsimore dhe aktivitete jashtëshkollore, në përputhje me ligjet dhe rregulloret federale dhe shtetërore. [1] [2]

### Përkufizimi i kushteve

**Edukimi dygjuhësh** - Programet akademike që mësohen në dy gjuhë me qëllimin që të gjithë nxënësit të bëhen dygjuhësh dhe dypalësh.

**CTE (Karriera dhe Edukimi Teknik)** - Programe akademike që specializohen në bizneset e afta, shkencat e aplikuar, teknologjitë moderne dhe përgatitjen e karrierës.

**EL (të) (Nxënësit)** - Nxënësit të cilët mësojnë anglisht si një gjuhë të dytë.

**ELD (Zhvillimi i Gjuhës Angleze)** - Udhëzim i krijuar posaçërisht për të zhvilluar aftësitë në gjuhën angleze.

**ESL (Anglishtja si gjuhë e dytë)** - programe akademike për nxënësit që mësojnë anglisht.

**FEL (s) (ish-nxënësit e gjuhës angleze)** - Nxënësit që kanë demonstruar aftësi në anglisht dhe nuk kualifikohen më si nxënës që kanë nevojë për ta përmirësuar atë.

**GIEP (Plani i Edukimit të individëve të talentuar)** - Një plan me shkrim që përshkruan arsimin që do të ofrohet për një nxënës të talentuar.

**HLS (Anketimi i gjuhës)** - Një studim i përfunduar për të gjithë nxënësit si pjesë e procesit të regjistrimit. Anketimi tregon gjuhën (ët) e përdorur në shtëpi.

**IEP (Plani i Edukimit i Individualizuar)** - Një plan me shkrim që përshkruan arsimimin për t'u siguruar një nxënës që ka aftësi të kufizuara sipas ligjit.

**LIEP (Programi Arsimor për Udhëzimin e Gjuhëve)** - Plani i drejtorisë arsimore dhe hartimi i udhëzimeve për nxënësit që mësojnë gjuhën angleze.

**Newcomer** - Një nxënës që anglishten e ka gjuhë të dytë dhe që ka qenë në Sh.B.A për më pak se një vit.

**PBIS (Ndërhyrje dhe Mbështetje të Sjelljes Pozitive)** - Një tabelë për miratimin e ndërhyrjeve të sjelljes bazuar në prova.

**SLIFE (Nxënës me arsim të kufizuar ose të ndërprerë)** - Një nën grup i larmishëm i nxënësve të cilët anglishten e kanë gjuhë të dytë, kanë njohuri të kufizuara në lexim dhe shkrim në gjuhën e tyre amtare dhe / ose që janë në nivelin e aftësive akademike për shkak të ndërprerjeve në procesin mësimor.

### **Autoritet**

SRC autorizon personin e caktuar për të aprovuar një program të shkruar mësimor për udhëzime të gjuhës (LIEP) për nxënësit, gjuha mbizotëruese e të cilëve nuk është anglisht dhe të ketë një zyrë për kurrikula dhe programe shumëgjuhëshe për të hartuar dhe mbështetur një plan që përfshin zhvillimin e gjuhës angleze (ELD) dhe programet mësimore dygjuhëshe. Programet duhet të bazohen në prova dhe zbatohen me burime të mjaftueshme dhe personel të trajnuar siç duhet. Programet vlerësohen rregullisht për efektivitetin në zhvillimin e aftësive gjuhësore të nxënësve dhe të drejtën në përmbajtje të nivelit të klasës. [2] [3] [4] [5]

I emëruari do të adresojë EL dhe programet në të gjitha funksionet e drejtorisë arsimore, partneritetet dhe proceset e planifikimit, siç është e nevojshme për të siguruar programe efektive udhëzimesh për arsimin dygjuhësh në përputhje me ligjet dhe rregulloret. Plani i Drejtorisë Arsimore për EL do të përfshijë: (1) përgatitjen dhe zhvillimin e duhur profesional për të gjithë personelin, duke përfshirë përmbajtjen thelbësore dhe mësuesit e klasave, mësuesit e ESL dhe drejtorët (2) burime të mjaftueshme për të zbatuar programin mësimor të gjuhës, përfshirë tekstet / materialet e duhura dhe teknologji mbështetëse (3) kurrikula dhe programim efektiv për të përmbushur nevojat e EL në nivele të ndryshme të aftësive, duke përfshirë të porsaardhurit, nxënësit me arsim të ndërprerë ose të kufizuar (SLIFE) dhe EL të moshave (18-21); (4) sisteme efektive dhe të arritshme të administrimit të të dhënave me pika të sakta dhe relevante të të dhënave EL; dhe (5) të drejtën gjuhësore për familjet dhe komunitetin. [3] [6]

### **Delegimi i Përgjegjësisë**

I emëruari do të zbatojë dhe mbikqyrë një program të Edukimit ELD / Bilingual që siguron udhëzime të duhura për EL në të gjitha shkollat dhe në përputhje me ligjet dhe rregullat federale dhe shtetërore.

I emëruari, në bashkëpunim me palët e interesuara të përshtatshme, do të hartojnë procedurë administrative në lidhje me programin e Edukimit dygjuhësh / ELD. Procedurat administrative do të rishikohen çdo vit, dhe do të bëhen publike përmes faqes së internetit të Drejtorisë Arsimore dhe zyrave përkatëse dhe do t'i shpërndahen administratorëve të Drejtorisë, administratorëve, mësuesve dhe

personelit në bazë shkolle, për të siguruar zbatimin e Politikës 138 duke u respektuar në mënyrë transparente, të vazhdueshme dhe të barabartë në të gjithë Drejtorinë.

## **Procedurat rregulluese të mandatuara**

### *Identifikimi, Vendosja dhe Njoftimet*

Drejtorja Arsimore vendos procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të nxënësve, gjuha mbizotëruese e të cilëve nuk është anglisht. Anketimi për gjuhën do të përfundojë për secilin nxënës pas regjistrimit. Nxënësit të cilët kërkojnë kontrollimin e gjuhëve për shërbimet ELD, bazuar në anketimin gjuhësorë, duhet të administrohen nga programi i aprovuar i gjuhës nga Departamenti i Edukimit të Pensilvanisë. Anketimi gjuhësor, rezultatet e kontrolluesit të gjuhës dhe niveli aktual i aftësisë së gjuhës siç tregohet nga vlerësimi vjetor i shtetit ELD, duhet të ruhen në dosjen e regjistrave të përhershëm të nxënësit dhe të regjistrohen në sistemin e informacionit të nxënësve të Drejtorisë Arsimore përmes diplomimit. [4] [7] [8]

Familjarët do të njoftohen, në gjuhën e preferuar të tyre, për hyrjen e nxënësve në shërbimet ELD, të drejtën e refuzimit siç përcaktohet me ligjin e shtetit, dhe nivelin e aftësive aktuale të gjuhës së nxënësve siç tregohet nga vlerësimi vjetor i shtetit ELD. [3]

Nxënësit që kanë dëftesë të shkollës së mesme (middle school) do të vlerësohet dëftesa në kohë të arsyeshme për të siguruar vendosjen e duhur në shkollë (high school). Nxënësit të EL do të regjistrohen në kurse të përshtatshme në bazë të krediteve, në përputhje me udhëzimet e Drejtorisë Arsimore për regjistrimin. Nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme do të vendosen në klasë të përshtatshme, në bazë të rregullave të Drejtorisë Arsimore.

Promovimi dhe ngelja në klasë e nxënësve EL duhet të bazohet në rregulloret e Drejtorisë Arsimore, Shtetit dhe Federale, dhe procedurat duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e Drejtorisë Arsimore. Një EL nuk mund të ngelet në klasë bazuar vetëm në mungesën e aftësisë së tij / saj në gjuhën angleze. [3]

Nxënësit do të riklasifikohen ose të dalin nga statusi i tyre EL në përputhje me kriteret e kërkuara të Drejtorisë, siç përcaktohet në ligjin shtetëror me njoftimin që u bëhet familjeve në gjuhën e tyre të preferuar. [3] [10]

## **Programimi**<sup>2</sup>

Të gjithë nxënësit e identifikuar si nxënës të cilët anglishten e kanë gjuhë të dytë (EL) do t'ju sigurohet një program arsimor i cili vlerëson burimet gjuhësore dhe kulturore të nxënësve, i bazuar në teori efektive të bazuar në kërkime të cilat u shërbejnë atyre.

Kurrikula duhet të bazohet në standarte dhe të modifikohet siç është e përshtatshme për EL. Në të gjitha programet gjuhësore, gjuhët dhe kulturat e nxënësve, si dhe përvojat e tyre arsimore nga vendlindja dhe familja, do të vlerësohen si një bazë e fortë, e cila nuk kufizohet tek nxënësit që marrin

pjesë në një program të caktuar të Edukimit Bilingual. [3]

LIEP duhet të përfshijë programin dygjuhësorë ose anglishten si përbërës të programit të Gjuhës së Dytë. Të dy programet e arsimit dygjuhësh dhe ESL duhet të jenë në përputhje me programin thelbësor mësimor dhe të përdorin personel mësimdhënës të çertifikuar për t'u siguruar nxënësve EL- mundësinë e plotë për të zotëruar njohuritë thelbësore dhe aftësitë e kurrikulës bazë.

Personeli do të përfshijë të gjitha modifikimet, ndërhyrjet dhe akomodimet e duhura në udhëzime dhe vlerësim për të lejuar EL-të të kenë akses domethënës në kurrikulën e përgjithshme dhe të promovojnë mësimin e gjuhës dhe përmbajtjes të përshtatshme për klasën. Programet nxirren nga burimet gjuhësore dhe kulturore të nxënësve dhe vlerësohen bazuar në përparimin drejt aftësive dhe arritjeve në lëndë thelbësore, përfshirë matematikën, leximin, shkencën dhe studimet shoqërore. [3]

Programet dygjuhëshe dhe ESL duhet të plotësojnë ose të tejkalojnë kërkesat minimale të Shtetit dhe të përfshijnë strategji mësimore dhe / ose kurrikula që integrojnë gjuhë dhe udhëzime të përmbajtjes që janë me kompetencë kulturore, dhe përputhen me standartet shtetërore dhe kombëtare.

Udhëzimi duhet të jetë "sfidë e lartë me mbështetje të lartë" për të siguruar të drejtën në programet dhe në kurrikulën thelbësore. Mësuesve të ESL dhe jo-ESL, do t'u ofrohen mundësi për të planifikuar mësimet në mënyrë bashkëpunuese për të siguruar zhvillimin e gjuhës akademike për të gjitha EL përfshirë nxënësit e porsaardhur. [3]

Programet e Edukimit dygjuhësh do të përfshijnë mësimin e gjuhës dhe të shkrim-leximit në anglisht si gjuhë të dytë dhe do të promovojnë dygjuhësinë, bilateralitetin dhe bikulturalizmin për të gjithë nxënësit. Aftësia e gjuhës dhe e shkrim-leximit, përfshirë aftësinë e leximit duhet të identifikohet dhe regjistrohet zyrtarisht si për anglisht ashtu edhe për gjuhën shtesë në dëftesat e notave të lëshuara nga Drejtoria Arsimore për nxënësit në programet dygjuhëshe. Mësimdhënësve dhe administratorëve do t'u ofrohen mundësi të vazhdueshme dhe të përshtatshme përgatitjeje në mënyrë që të zbatojnë dhe mbështesin në mënyrë efektive programet e Edukimit Dygjuhësh dhe duhet të jenë të çertifikuar, siç tregohet në udhëzimet e Drejtorisë Arsimore [3]

Programet e Edukimit ESL duhet të përfshijnë udhëzimet për Zhvillimin e Gjuhës Angleze (ELD) të përvetësuar nga mësuesit e çertifikuar të ESL në përputhje me kërkesat e Shtetit. ELD duhet të përfshihet në të gjitha klasat nga mësuesit ESL dhe jo-ESL të certifikuar, të cilat janë regjistruar EL. Të gjithë mësuesit e EL janë përgjegjës për planifikimin dhe përfshirjen e mësimëve gjuhësore, si dhe mbështetjet, modifikimet, ndërhyrjet dhe akomodimet e duhura për të lejuar EL që të kenë plotësisht të drejtën në standartet e kurseve dhe programet mësimore. Udhëzimet ELD nga mësuesit ESL dhe jo-ESL do të promovojnë përdorimin e aftësive dhe kulturës së gjuhës të nxënësve për të mbështetur dhe forcuar mësimin dhe zhvillimin e përmbajtjes, aftësive dhe njohurive thelbësore. Udhëzimet ELD nga mësuesit dhe administratorët e klasës ESL dhe jo-ESL / mësuesit e lëndëve dhe administratorët do të mbështeten përmes arsimit plotësues dhe bazuar në hulumtime dhe mundësi të zhvillimit profesional, në mënyrë që të zbatojnë në mënyrë efektive dhe të mbështesin programe efektive ESL. [3]

#### **E drejta e barabartë**<sup>4</sup>

Studentëve të EL, në të gjitha nivelet e aftësisë gjuhësore, do të kërkohet me akomodim, të marrin pjesë në vlerësime, sipas rastit, dhe të plotësojnë standartet e përcaktuara akademike dhe kërkesat e diplomimit. [9] [10] [11] [14] [15] [16] [17] [18] [19] [20] [21]

Në bazë të krijimit të një ambienti shkollor pozitiv dhe të sigurt për të gjithë nxënësit, rregullat e drejtorisë arsimore vlejné për të gjithë nxënësit , pavarësisht nga statusi i imigracionit, por jo i kufizuar në rregulloren 248 dhe 249 të ngacimit; Politika e Edukimit Gjiner Multiracial, Multicultural, Gjiner 102; Mosdiskriminimi në klasë,rregulli 103; Rregullorja 251 e nxënësve të pastrehë ; Rregullorja 252 për transgjinerë dhe gjini të pakonfirmuar.

Nxënësit do të kenë të drejta të barabarta dhe do të inkurajohen të marrin pjesë në të gjitha programet akademike, përfshirë Karrierën dhe Edukimin Teknik, shkollat dhe programet speciale për pranime / magnet, dhe aktivitetet dhe programet jashtëshkollore në dispozicion të nxënësve të drejtorisë arsimore. Nxënësit do të ndihmohen nga persona të ditur për shkollat dhe programet për të marrë në konsideratë një sërë programesh dhe për të marrë akomodimet dhe mbështetjet e nevojshme për nxënësit që të jenë të suksesshëm, përfshirë modifikimet. Familjet do të marrin udhëzime në gjuhën që ata kuptojnë. Nxënësit mund të mos përjashtohen në bazë të kritereve të pranimit nëse ata mund të marrin pjesë me sukses, duke pasur parasysh akomodime të arsyeshme. [22] [23] [24] [25]

Nxënësit e EL në të gjitha mjediset, duke përfshirë vendosjet alternative, programet e të porsa ardhurve, pranimin special / magnet, pranimin në të gjithë qytetin, Karrierën dhe Edukimin Teknik (CTE), nxënësit me një Plan të Edukimit të Individualizuar (IEP), Planin e Edukimit të Personalizuar të talentuar (GIEP), Plani 504, ose nxënësit në shkolla me regjistrim të ulët të EL, të gjithë janë nxënës të EL kanë të drejtë për Programet e Edukimit të Individualizuar (IEP), 504 Plane dhe / ose Programet e Edukimit të Talentuar (GIEP), dhe do të identifikohen në përputhje me ligjin dhe rregulloret e drejtorisë arsimore. Drejtoria Arsimore do të sigurojë që vlerësimi i një nxënësi për shërbime arsimore të individualizuara dhe të talentuara përfshin konsiderimin e faktorëve ndërhyrës, siç është aftësia në anglisht, që mund të ndërhyjë në aftësinë e zyrtarëve të shkollës për të identifikuar aftësi të ndryshme të të mësuarit. [13] [5] [12]

Aftësia gjuhësore e nxënësve ose statusi i EL nuk mund të jenë arsye për të mohuar ose vonuar vlerësimin për të përcaktuar pranueshmërinë për shërbime të veçanta arsimore. EL mund të jenë të pranueshëm për shërbime të veçanta arsimore kur ata janë identifikuar si nxënës me aftësi të kufizuara dhe është përcaktuar që paaftësia nuk është vetëm për shkak të mungesës së udhëzimeve ose aftësive në gjuhën angleze. Një vlerësim për një nxënësi të EL duhet të bëhet në një gjuhë që nxënësi e kupton të vlerësojë me saktësi pranueshmërinë me vlerësime dygjuhëshe të kryera kur është e mundur në përputhje me ligjet shtetërore dhe federale. Prindërve / kujdestarëve do t'u ofrohen shërbime të interpretimit dhe të përkthimit të Drejtorisë Arsimore në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtë për të siguruar pjesëmarrje të konsiderueshme në procesin e arsimit special. [3] [5] [12]

Nxënësit EL të cilët kanë të drejtë për shërbime të specializuara të arsimit do të vazhdojnë të marrin udhëzime për arsimin ESL / Dygjuhësh në përputhje me programin e tyre të arsimit të individualizuar (IEP), Planin e Edukimit të Personalizuar të Talentuar (GIEP), ose Plani 504, në nivelin e duhur të aftësive gjuhësore dhe të zhvillimit, dhe me monitorim të rregullt nga një specialist i ESL ose një person i trajnuar. [5] [12] [13]

Nxënësit që janë EL mund të qëndrojnë në shkollë të mesme deri në moshën 21- vjecare , pavarësisht nga kreditë e marra. Nxënësit që nuk mbarojnë shkollën e mesme deri në moshën 21 vjeç kanë të drejtë për programe arsimore alternative me ELD dhe klasa të cilat konsiderohen të përshtatshme dhe të domosdoshme për t'i mundësuar nxënësit të marrin një diplomë të shkollës së mesme.

## *Vlerësimi*<sup>1</sup>

Plani i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias për EL, përfshirë programet e arsimit ESL dhe Dygjuhësh, ofertat e mbledhjeve profesionale, programet mësimore dhe udhëzimet do të vlerësohen rregullisht nga zyrat e drejtorisë, mbikëqyrësit dhe administratorët e shkollave duke u bazuar dhe në mendimet e nxënësve, prindërve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit të paktën një herë në tre vjet, për të siguruar që të gjithë komponentët të jenë në përputhje me standartet akademike dhe do të rishikohen kur është e nevojshme për të siguruar arritje më të mëdha të nxënësve. [9] [10] [11]

Nxënësit që janë EL duhet të vlerësohen çdo vit me vlerësimin e zhvillimit të gjuhës angleze të shtetit të Pensilvanisë. [3]

Shkollat në mënyrë individuale dhe Programi ESL do të mbledhin dhe shpërndajnë të dhëna bazuar në progresin e nxënësve siç raportohet për të informuar planifikimin e drejtorisë dhe të shkollës, përfshirë planifikimin e përmirësimit të shkollës. [5] [12]

## *Angazhimi i Prindërve, Familjeve dhe Komunitetit*<sup>2</sup>

Për të siguruar një pjesëmarrje të konsiderueshme për prindërit / kujdestarët gjuha dominuese e të cilëve nuk është anglisht do t'u ofrohen shërbime të duhura për interpretim dhe përkthim nga Drejtoria Arsimore. Këto shërbime, përfshirë trajnimin për familjet se si të përfshihen në edukimin e nxënësve dhe të eliminojnë pengesat për përfshirjen e familjes do të ofrohen nga profesionistë të trajnuar. Drejtoria Arsimore do të sigurojë trajnim të mjaftueshëm të personelit për të siguruar të drejta gjuhësore për të gjitha familjet. [1] [3]

Administratorët e shkollës duhet të mbajnë një rekord për prindërit, për të cilët anglishtja është gjuhë e dytë dhe të sigurojnë mundësitë që prindërit të marrin informacionet në gjuhën e tyre. [1][3] Drejtoria Arsimore do të përdorë mjete të qarta, gjithëpërfshirëse dhe të besueshme për të arritur një pjesëmarrje të konsiderueshme të prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre. Programi (et) i dizajnuar për t'u drejtuar prindërve do të monitorohet me kujdes dhe vlerësohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë Arsimore ose administrata e programit dhe shkollës në përputhje me Departamentin e Arsimit të Pensilvanisë dhe standartet federale të Shteteve të Bashkuara, për efektivitetin. [3] [9] [10]

Takimet vjetore do të caktohen nga administratorët e duhur të Drejtorisë Arsimore për palët e interesuara të komunitetit, për të rishikuar Rregulloren 138.

---

<sup>1</sup> Procedurat administrative specifikohen në seksionin "Vlerësimi i Programit" në seksionin " Broshura për Programin e Nxënësve që Mësojnë Anglisht".

<sup>2</sup> Procedurat administrative specifikohen në seksionin "Komunikimi i prindërve dhe komunitetit" të seksionit " Broshura për Programin e Nxënësve që Mësojnë Anglisht."

**Referencat ligjore:**

1. 42 U.S.C. 2000d et seq
2. Pol. 103 - Mosdiskriminimi në shkollë dhe praktika në klasë 3. 22 Kodi PA 4.26
4. 20 U.S.C. 6801 et seq
5. Pol. 103.1 - Mosdiskriminimi - Nxënës me Aftësi të Kufizuara / Mbrojtja e Nxënësve me Aftësi të Kufizuara
6. Pol. 333 - Zhvillimi Profesional 7. 22 Kodi PA 11.11
8. Pol. 200 - Regjistrimi i nxënësve 9. 20 U.S.C. 6812
10. 20 U.S.C. 6826
11. 20 U.S.C. 6841
12. Pol. 113 - Arsime special
13. Pol. 114 - Edukimi i talentuar 14. 20 U.S.C. 6842
15. 22 Kodi PA 4.51
16. 22 Kodi i PA 4.51a
17. 22 Kodi i PA 4.51b
18. 22 Kodi i PA 4.51c
19. 22 Kodi i PA 4.52
20. Pol. 127 - Vlerësimet
21. Pol. 217 - Diplomimi 22. 20 U.S.C. 1703
23. Pol. 115 - Edukimi i Karrierës dhe Teknikës
24. Pol. 122 - Aktivitete jashtëshkollore
25. Pol. 123 - Atletika ndër- shkollore

**Informacione të Ngjashme:**

- 34 CFR Pjesa 200
- LeGare 1994, Dekret i Pëlqimit
- Pol. 304 - Punësimi i personelit të Drejtorisë